UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI
Pranuar me dt. 13.11.2026
Njesia orga | Nr.ji | Nr.Ekzem | Vlera
285311

UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti Juridik

Kryesues i Këshillit
Prof. Asoc. Dr. Islam Qerimi

Nr. Prot. 420/1 Dt. 13.11.2026

KËSHILLI I FAKULTETIT JURIDIK, në mbështetje të nenit 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nenit 22 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit, Rregulloren për procedura vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, me nr. prot. 1670 dt. 28.09.2021, nenin 4, paragrafin 1 të Rregullores me nr. prot. 2205, datë 26.09.2025, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, sipas konkursit të UIBM-it, lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM me nr. prot. 2526, të datës 19.10.2026, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 12.11.2026 nxjerr këtë:

PROPOZIM – VENDIM

APROVOHET – Raporti i komisionit vlerësues me numër nr. prot. 411, dt. 10.11.2026

ARSYETIM

Në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit Juridik, të mbajtur më datë 12.11.2026, anëtarët e Këshillit shqyrtuan Raportin e Komisionit Vlerësues, me nr. prot. 411, të datës 10.11.2026, lidhur me vlerësimin e kandidatëve të paraqitur në konkursin e datës 10.10.2025, për angazhimin e një (1) bashkëpunëtori të jashtëm në cilësinë e asistentit të angazhuar në Fakultetin Juridik, për vitin akademik 2026/2027, për lëndët mësimore si në vijim:

- E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- E drejta e Bashkimit Evropian;
- E drejta ndërkombëtare publike;
- Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare;
- Tema të zgjedhura nga e drejta e Bashkimit Evropian.

Për pozitën e lartcekur kanë aplikuar dy (2) kandidate: Fatjona Musliu dhe Kreshnike Kadriaj. Pas shqyrtimit të raportit të Komisionit Vlerësues dhe diskutimeve lidhur me vlerësimin e aplikacioneve dhe përmbushjen e kritereve të përcaktuara në konkurs, Këshilli i Fakultetit Juridik miratoi Raportin e Komisionit Vlerësues, me të cilin kandidatja Fatjona Musliu është propozuar për angazhim në pozitën e bashkëpunëtores së jashtme – asistente, për mbajtjen e ushtrimeve në lëndët e sipërcekura, për vitin akademik 2026/2027. Këshilli vendosi se kandidatja e propozuar, Fatjona Musliu i përmbush kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkursin përkatës, si dhe aktet normative në fuqi të UIBM-së. Si rrjedhoj u vendos si në dispozitiv.

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit

Prof. Dr. Islam Qerimi

I dërgohet:
Zyrës për çështje akademike të UIBM,
Komisionit Qendror të Studimeve,
Dekanit të FJ,
Sekretarit të FJ,
Arkivit të Fakultetit.

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI
Pranuar me dt. 13.11.2026
Nr. Shërbimi | Num | Nr Ekzem | Vlera
285312

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI JURIDIK
Pranuar me dt. 10.11.2026
Njësia organ. | Numër | Nr.Ekzemipl. | Vlera
4M

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES

Fakulteti	Juridik
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	1.E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut 2.E drejta e BE-së, 3.E drejta ndërkombëtare publike 4.Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare 5.Tema të zgjedhura nga e drejta e BE-së
Kandidatët e paraqitur:	1. Fatjona Musliu 2. Kreshnike Kadriaj

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar/e	*Prof. asoc. dr. Besnik Murati*
2. Anëtar/e	*Prof. asoc. dr. Përparim Gruda*
3. Anëtar/e	*Prof. ass. dr. Arta Dauti*

Shënimet për kandidatin/en për të cilin/ën shkruhet raporti
Kandidatja 1

Emri dhe mbiemri	*Fatjona Musliu*
Datëlindja	*18.11.2002*
Vendlindja	*Kçiq i Madh, Mitrovicë*
Grada shkencore	*LL.M. (Master) në të Drejtën Ndërkombëtare*
Arsimimi i lartë	
Studimet e Doktorates	
-Universiteti/Fakulteti	/
-Departamenti:	/
-Titulli i fituar	/
-Viti i doktorimit	/
-Nota mesatare:	/
-Nostrifikimi nëse ka studiuar jashtë vendit:	/
Studimet Master/Magjistraturë	
-Universiteti/Fakulteti	*Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" / Fakulteti Juridik*
-Departamenti	*E drejta ndërkombëtare*
-Titulli i fituar	*LL.M. (Master) në të Drejtën Ndërkombëtare*
-Viti i Diplomimit	*22.09.2026 (Diploma Nr. 3426, datë 25.09.2026)*
- Nota mesatare	*9.63*
-Nostrifikimi nëse ka studiuar jashtë vendit	/
Studimet Themelore	
-Universiteti/Fakulteti	*Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë / Fakulteti Juridik*
-Departamenti	*Juridik*
-Titulli i fituar	*Jurist i diplomuar – Bachelor*
-Viti i Diplomimit	*08.07.2024 (Diploma Nr. 230, datë 02.09.2024)*
- Nota mesatare	*9.55*
-Nostrifikimi nëse ka studiuar jashtë vendit	/

Kandidatja 2

Emri dhe mbiemri	*Kreshnike Kadriaj*
Datëlindja	*02.05.1989*
Vendlindja	*Prizren*
Grada shkencore	*LL.M. (Master) në të Drejtën Ndërkombëtare; doktorante (PhD Cand)*
Arsimimi i lartë	
Studimet e Doktorates	
-Universiteti/Fakulteti	*Universiteti Selçuk, Konya / Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik, Shkup – Fakulteti Juridik*
-Departamenti:	*E drejta ndërkombëtare*
-Titulli i fituar	*(doktorante në të Drejtën Ndërkombëtare, studimet nuk janë përfunduar)*
-Nota mesatare:	/
-Nostrifikimi nëse ka studiuar jashtë vendit:	/

Studimet Master/Magjistraturë	
-Universiteti/Fakulteti	*Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" / Fakulteti Juridik*
-Departamenti	*Ndërkombëtar*
-Titulli i fituar	*LL.M. (Master) në të Drejtën Ndërkombëtare*
-Viti i Diplomimit	*01.09.2020 (Diploma Nr. 2382, datë 09.09.2020)*
- Nota mesatare	*8.38*
-Nostrifikimi nëse ka studiuar jashtë vendit	/
Studimet Themelore	
-Universiteti/Fakulteti	*Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" / Fakulteti Juridik*
-Departamenti	*Juridik*
-Titulli i fituar	*Bachelor në Juridik*
-Viti i Diplomimit	*04.04.2018 (Diploma Nr. 444, datë 04.05.2018)*
- Nota mesatare	*7.55*
-Nostrifikimi nëse ka studiuar jashtë vendit	/

Sqarim: Në këtë tabelë paraqitën shenimet për secilin kandidatë që i shkruhet raporti. Të shtohën tabela, varësisht nga numri i kandidatëve
Sqarim: Kandidatet te cilët krahas gradës doktor i shkencave kane edhe titullin akademike te ligjëruesit ose profesorit, te fituar ne UP, kane përparësi ne përzgjedhje ndërsa për bashkëpunëtor te jashtëm për ushtrime kandidatet nuk e jete jo me i vjetër 30 vjet kur angazhohet për herë të pare.

Vërejtje: Arsyetimi për mos hartimin e raportit për kandidaten Kreshnike Kadriaj jepet te pjesa "Përfundimi dhe propozimi".

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit, Tabela I:

Tabela I: Punimet e publikuara pas thirrjes së fundit në revista, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike, sipas Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024 dhe me Vendimin e Senatit me nr.prot.1757 dt.06.08.2024.

Nr	**Autori/ët**	**Titulli i punimit**	**Platforma**	**Koeficienti i Revistës (indeksimi)**	**Revista**	**Vëllimi, nr., faqet, viti**	**Linku identifikues** [1]
/	/	/	/	/	/	/	/

Sqarim: Autor i parë konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve. Autori korrespodent konsiderohet autori i punimit, i cili shprehimisht është përcaktuar si i tillë në punim. Nëse

[1] Komisioni vlerësues është i obliguar të shënojnë linkun nëpërmjet të të cilit dëshmohet indeksimi i punimit përkatësisht revistës në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse

në punimin e publikuar janë specifikuar më shumë se 1 (një) autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë. Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autorë dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent.
Në tabelë duhet të prezantohen punimet pas thirrjes së fundit. Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UIBM -së dhe Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024. Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave për punimet e radhitura në këtë tabelë.

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën I.

(Komisioni vleresues duhet të japë informata për tipin e publikimeve, për revistën në të cilën ka botuar autori duke iu referuar statusit të kandidatit në kuadër të punimit (p.sh. autor i parë etj), "impact factorin" e revistës, shtëpinë botuese, "impact factorin" personal, etj. Komisioni duhet të precizojë burimin e informatave në të cilin është mbështetur dhe i cili mund të verifikohet. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhët të bashkëngjiten në këtë raport)

Burimi i të dhënave është CV-ja (format Europass, 2026) dhe dokumentet në form fizike dhe elektronike të dorëzuar nga kandidatja në konkurs. Sipas saj, kandidatja Fatjona Musliu nuk ka punime të publikuara në revista të indeksuara në bazat akademike, prandaj Tabela I nuk përmban asnjë punim.
Në CV janë shënuar tri punime hulumtuese/artikuj të realizuar në kuadër të organizatave joqeveritare: hulumtimi "Migrimi për motive punësimi në Kosovë: Quo Vadis" (Lens NGO, 2023); artikulli "Integrimi i personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës" (SIT – Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Kërkime, 2023); hulumtimi "Analiza e legjislacionit të punës në vendet e Ballkanit Perëndimor" (Lens NGO, 2024). Këto nuk janë publikime në revista të indeksuara dhe nuk radhiten në Tabelën I, por dëshmojnë angazhim në hulumtim juridik dhe analizë të legjislacionit.

Tabela II. Mentorimi

Emri Mbiemri (i kandidatit/es)	Diploma/ Niveli i studimit	Data e regjistrimit/ lejimit të punimit	Në proces	Data e përfundimit
/	/	/	/	/

Sqarim: Plotësohet tabela me emrat e kandidatëve të cilët i ka mentoruar pas thirrjes së fundit.

2. Pervoja në mësimdhënie universitare

(Në këtë pjesë të raportit shënohën gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, universitetet ku ai ka punuar, programet akademike, kualifikimet, angazhimi në institucione jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e *paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).*

Kandidatja Fatjona Musliu nuk ka grada doktorale dhe nuk mban titull akademik. Sipas CV-së dhe dokumenteve në form fizike dhe elektronike të dorëzuar nuk ka përvojë paraprake në mësimdhënie universitare në ndonjë institucion të arsimit të lartë.
Arsimimi: Jurist i diplomuar – Bachelor në Fakultetin Juridik të Universitetit "Isa Boletini" në

Mitrovicë (regjistruar 2020/2021, studimet i ka mbaruar më 08.07.2024, nota mesatare 9.55) dhe LL.M. (Master) në të Drejtën Ndërkombëtare në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (regjistruar 2024/2025, studimet i ka mbaruar më 22.09.2026, nota mesatare 9.63). Drejtimi i masterit përputhet drejtpërdrejt me lëndët e shpallura në konkurs (E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, E drejta e BE-së, E drejta ndërkombëtare publike, Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare, Tema të zgjedhura nga e drejta e BE-së).
Kualifikime të lidhura me mbështetjen e punës akademike: kandidatja ka përvojë në hulumtim dhe analizë ligjore, në hartim raportesh dhe në përkthim nga anglishtja në shqip e anasjelltas; njohuritë e gjuhëve: anglisht C1 (të kuptuarit dhe shkrimi) dhe B2 (të folurit), turqisht B1–C1, gjermanisht A1. Në vitet e studimeve ka qenë bursiste (Bachelor dhe Master) dhe i është dhënë mirënjohje si studente e dalluar e Fakultetit Juridik të UIBM-së.

Tabela III. Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave etj.

Nr	Autori/ët	Titulli i publikimit	Shtëpia botuese, vendi, viti	Numri i ISBN
/	/	/	/	/

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave të radhitura në tabelën III.

Tabela IV. Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, nivel ndërkombëtar dhe vendore

Nr	Autori/ët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi, vëllimi, nr., faqet, viti etj.	Certifikata e prezantimit ose agjenda
/	/	/	/	/

Tabela V. Ligjëratat-prezantimet, ligjërues i ftuar në universitet dhe punëtori shkencore nga lëmi i kandidatit

Nr	Autorët (renditja si në Ligjërate/Prezantim)	Titulli i ligjëratës	Lloji i ligjëratës (Universitet, Punëtori Shkencore)	Viti, Vendi
/	/	/	/	/

Tabela VI. Redaktor/Recensent në revistat akademike apo shkencore

Nr	Kontributi (redaktor/recensent)	Autori/ët e punimit	Titulli i punimit të recensuar	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recensioni	Vendi, Viti

/	/	/	/	/	/

3. Përvoja menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udheheqese, projektet shkencore dhe projektet e tjera në të cilat ka marrë pjesë kandidati, statusi i tij në projekt, programi prej të cilit është financuar projekti, çmimet dhe mirënjohjet, kualifikimet e ndryshme, patentat, inovacioni etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Përvoja profesionale dhe angazhimet e kandidates Fatjona Musliu (sipas CV-së dhe dokumenteve në form fizike dhe elektronike të dorëzuar):

- Zyrtare e monitorimit, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Mitrovicë, nga 01.09.2024 (aktualisht): monitorimi i seancave gjyqësore (konteste pronësore dhe raste të dhunës me bazë gjinore), analiza e vendimeve gjyqësore dhe praktikave juridike, identifikimi i shkeljeve procedurale dhe materiale, hartimi i raporteve ditore, hulumtim dhe analizë ligjore.
- Organizata ACDC (Advocacy Center for Democratic Culture), Mitrovicë, 01.03.2024 – 30.08.2024: hartimi i raporteve, organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve, përkthim anglisht–shqip.
- Inspektorati i Punës, Mitrovicë, 15.03.2024 – 15.06.2024: asistim në inspektime dhe riinspektime, hartim raportesh dhe vendimesh administrative.
- Klinika Juridike, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Prishtinë, 20.11.2023 – 05.03.2024: ofrim i ndihmës juridike falas, trajnime dhe vizita institucionale.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 15.11.2022 – 15.05.2023: monitorim i Komisionit për Legjislacion, komisioneve të tjera dhe seancave plenare.
- Trajnime dhe programe të lidhura me lëndët e konkursit (mbi 20 trajnime, punëtori dhe aktivitete gjithsej): "E drejta pronësore sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut" (OSBE, 25.05.2022); trajnim mbi të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe sistemin gjyqësor (YIHR, 13–15.02.2023); trajnime mbi ndërmjetësimin (Ambasada e SHBA-së dhe Akademia Juridike, 03–07.02.2023 dhe 29–30.04.2023); "Programet dhe standardet e punës … Konventën e Stambollit" (SIT, 27.04.2023); "Akademia për të Drejtat e Punës" (Lens, 30.09–04.10.2023); "Programi i Mentorimit të Lidershipit" (NDI & NED, 17.11.2023 – 17.04.2024); "Si të shkruani një hulumtim?" (NSI, 02–04.03.2024); "Akademia për Politika Publike dhe Sociale" (Instituti "Musine Kokalari", 08–13.07.2024); "Shkolla Verore mbi Gjininë, Ekonominë dhe Politikat 2024" (NDI, 27–31.08.2024).
- Mirënjohje dhe çmime: mirënjohje si studente e dalluar e Fakultetit Juridik të UIBM-së; bursiste gjatë katër viteve të Bachelor dhe në Master.

4. Mobiliteti i kandidatit/es

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ai ka qëndruar për qellime pedagogjike shkencore, qendrime: hulumtuese jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse per te dhenat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Sipas CV-së dhe dokumenteve në form fizike dhe elektronike të dorëzuar, kandidatja Fatjona Musliu ka studiuar vetëm në Kosovë: Bachelor në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe Master në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Nuk shënohet qëndrim studimor, hulumtues apo

pedagogjik jashtë vendit, prandaj nuk lind nevoja për nostrifikim diplomash.

TABELAT E MËSIPËRME DUHET PLOTËSUAR PËR ÇDO KANDIDAT/E VEÇ E VEÇ

Përfundimi dhe propozimi

(Anëtaret e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të shkurtër për kandidatin të cili propozohet si bashkëpunëtorë i jashtëm. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë propozimin e tyre vetëm për një kandidat për një pozitë (ose për më tepër kandidatë, nëse ashtu është kërkuar me konkurs). Komisioni vlerësues përmbledh të dhënat për kandidatët që kanë aplikuar dhe sjell konkludimin dhe propozimin e arsyetuar për kandidatin dhe titullin në të cilin propozohet (sipas kërkesave të konkursit, Statutit dhe pozitës së shpallur) për kandidatin i cili propozohet për pozitën e shpallur. Kjo pjesë e raportit është e përbashkët për të gjithë kandidatet, ndërsa 4 kapitujt paraprakë shkruhen për secilin kandidat veç e veç (për te gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim sipas Statutit dhe konkursit).

Këshilli i Fakultetit Juridik të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, formoi komisionin vlerësues me Vendim Nr. Prot. 370, datë: 26.10.2026 në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Besnik Murati - Kryetar; Prof. Asoc. Dr. Përparim Gruda - Anëtar; Prof. Ass. Dr. Arta Dauti - Anëtare, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për lëndët: E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; E drejta e BE-së; E drejta ndërkombëtare publike; Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare; Tema të zgjedhura nga e drejta e BE-së.

Komisioni vlerësues pasi analizoi dokumentacionin e prezentuar nga kandidatet Fatjona Musliu dhe Kreshnike Kadriaj, të cilat kanë aplikuar për angazhim si bashkëpunëtore të jashtme (asistente) për lëndët e sipërpërmendura, konstaton se vetëm kandidatja Fatjona Musliu i plotëson kushtet e përcaktuara sipas akteve normative të UIBM, për rrjedhojë i shkruhet raporti vlerësues.

Bazuar në Rregulloren për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes, Rizgjedhjes dhe Avancimit të Personelit Akademik në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, me Nr. Prot. 3013/1, Dt. 21.12.2023, përkatësisht në Nenin 16, pika 21, ku thuhet "...Për kandidatë të cilët nuk i kan plotësuar kushtet formale nuk shkruhet raporti, por cekët kushti që nuk e kan plotësuar".

Komisioni vlerësues pas shqyrtimit të aplikacioneve konstaton se kandidatja Kreshnike Kadriaj nuk i plotëson kushtet formale për t'u zgjedhur bashkëpunëtore e jashtme (asistente) i/e angazhuar për grup lëndësh nga e drejta ndërkombëtare, për vitin akademik 2026-2027, sipas Statutit të UIBM, Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, me nr. prot. 1670 të datës 28.09.2021 si dhe Plotësim ndryshimit të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, me nr. prot. 2205 të datës 26.09.2025, konkursit publik me nr. prot. 2526 të datës 19.10.2026, për rrjedhojë kandidates Kreshnike Kadriaj nuk i shkruhet raport recensues.

Kandidatja Kreshnike Kadriaj nuk i plotëson kushtet formale sipas nenit 7, pika 3.2 Të ketë noten mesatare jo më të vogel se 8 në të dy nivelet e studimit dhe 3.3 Të jetë jo më i vjetër se 30 vjet kur angazhohet për herë të parë, të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, me nr. prot. 1670 të datës 28.09.2021 si dhe Plotësim ndryshimit të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, me nr. prot. 2205 të datës 26.09.2025.

Komisioni vlerësues konstaton se kandidatja Fatjona Musliu në vitin 2026 ka përfunduar Masterin në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë-Republika e Kosovës, drejtimi E drejta ndërkombëtare, ku edhe ka fituar titullin LL.M. (Master) në të Drejtën Ndërkombëtare.

Në vitin 2024 ka përfunduar studimet Bachelor në Fakultetin Juridik në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë-Republika e Kosovës, ku edhe ka fituar titullin Jurist i diplomuar – Bachelor.
Përveç studimeve, kandidatja Fatjona Musliu ka bërë hulumtime si: hulumtimin "Migrimi për motive punësimi në Kosovë: Quo Vadis" (Lens NGO, 2023), artikullin "Integrimi i personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës" (SIT, 2023) dhe hulumtimin "Analiza e legjislacionit të punës në vendet e Ballkanit Perëndimor" (Lens NGO, 2024).
Kandidatja nga 01.09.2024 shërben si Zyrtare e Monitorimit në Grupin për Studime Juridike dhe Politike në Mitrovicë, si dhe ka kryer praktika profesionale në organizatën ACDC, në Inspektoratin e Punës, në Klinikën Juridike të Institutit të Kosovës për Drejtësi dhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Hartimi i raportit konform legjislacionit në fuqi

Komisioni vlerësues në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Besnik Murati - Kryetar; Prof. Asoc. Dr. Përparim Gruda - Anëtar; Prof. Ass. Dr. Arta Dauti - Anëtare, konstaton se aplikimi i kandidates Fatjona Musliu është bërë konform kërkesave të konkursit me Nr. Prot. 2526, datë: 19.10.2026, dhe janë plotësuar kushtet konform Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, si dhe Rregullores nr. 1670, datë 28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, dhe Rregullores nr. 2205, datë 26.09.2025, për plotësimin dhe ndryshimin e saj, komisioni vlerësues erdhi në përfundim dhe propozon si në vijim:

PROPOZIM

Komisioni vlerësues pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentacionit të paraqitur, vlerëson se kandidatja Fatjona Musliu i plotëson të gjitha kushtet e parapara me dispozitat ligjore në fuqi (Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statuti i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Rregullorja nr. 1670, datë 28.09.2021, dhe Rregullorja nr. 2205, datë 26.09.2025) për t'u angazhuar si bashkëpunëtore e jashtme (asistente). Duke marrë parasysh atë se çka u theksua më lart, komisioni vlerësues i PROPOZON Këshillit të Fakultetit Juridik dhe Senatit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë që të angazhojë kandidaten Fatjona Musliu si bashkëpunëtore e jashtme (asistente) për lëndët: E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; E drejta e BE-së; E drejta ndërkombëtare publike; Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare; Tema të zgjedhura nga e drejta e BE-së, për vitin akademik 2026/2027.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:
[*të shënohet thirrja e saktë akademike*]

1. Prof. asoc. dr. Besnik Murati - Kryetar

2. Prof. asoc. dr. Përparim Gruda-Anëtar

3. Prof. ass. dr. Arta Dauti- Anëtare

Datë: 10/11/2026